

20151694755

L I G J
PËR SHPALLJEN E QENDRËS SË VJETËR TË QYTETIT TË MANASTIRIT
TRASHËGIMI KULTURORE ME RËNDËSI TË VEÇANTË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

(1) Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit, e cila paraqet tërësi monumentale, shpallet trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë, nënkategoria – rëndësi e madhe.

(2) Me shpalljen e tërësisë monumentale “Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit” trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë, mundësohet:

- ruajtja e përhershme e vlerave historike, artistike, arkitektonike, urbanistike, etnologjike dhe sociologjike të tërësisë monumentale, si dhe e autenticitetit, veçantisë, llojllojshmërisë, integralitetit, vjetërsisë, rrënjësisë dhe vetive tjera dhe përmbajtjeve të vetë tërësisë;

- krijimi i kushteve më të volitshme për mbijetesë dhe ruajtje të integritetit të të gjitha të dhënave që ajo tërësi i bart me vete si dëshmim;

- zgjerimi i njohurive për vlerat, rëndësinë dhe rolin e tërësisë monumentale në identifikimin kulturor;

- aftësimi i të mirës të shërbejë për plotësimin e nevojave kulturore, shkencore, edukative, estetike, religjioze, ekonomike, turistike dhe nevojave tjera të qytetarëve dhe

- parandalimi i veprimeve, dukurive dhe ndikimeve me të cilat kryhet ose mund të shkaktohet dëmtimi ose degradimi i tërësisë së mbrojtur.

(3) Tërësia monumentale “Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit”, e krijuar gjatë periudhës së shekullit XV mbi strukturën urbane të shekullit të mesëm dhe është zhvilluar në vazhdimësi deri në shekullin XXI, si trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë, është e mirë me interes të përgjithshëm për Republikën e Maqedonisë dhe gëzon mbrojtje të veçantë në pajtim me këtë ligj, me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe me ligj tjetër.

Neni 2

(1) Tërësia monumentale “Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit” (në tekstin në vijim: Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit) ka sipërfaqe prej gjithsej 109,22 hektarë dhe gjendet në lartësi mbidetare prej 607 deri në 635 metra.

(2) Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit gjendet në rajonin e komunës së Manastirit dhe përfshin hapësirën me koordinatat si vijon:

- pika më lindore $X = 41^{\circ} 01' 51,50''$ $Y = 21^{\circ} 20' 29,60''$,
- pika më jugore $X = 41^{\circ} 01' 24,79''$ $Y = 21^{\circ} 20' 21,30''$,
- pika më perëndimore $X = 41^{\circ} 01' 56,01''$ $Y = 21^{\circ} 19' 24,59''$,
- pika më veriore $X = 41^{\circ} 02' 06,26''$ $Y = 21^{\circ} 20' 04,30''$.

Neni 3

Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit i ka kufijtë si vijon:

- Në lindje kufiri fillon në rajonin e KK Manastir 4, nga pika prerëse e boshtit të rrugës “Gostivarska” (PK 2946) me boshtin e rrugës “Sveti Naum” (PK 99999.14), si pikë e nisjes e kufirit lindor të të mirës dhe lëviz në drejtim të jugut përgjatë boshtit të rrugës “Sveti Naum” deri te pika e prerjes në drejtim të boshtit të saj me boshtin e rrugës “Ivan Millutinoviq” (PK 19302), kthen në drejtim të veri-lindjes dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës “Ivan Millutinoviq” deri te pika e prerjes në drejtim të boshtit të rrugës “Ilo Xhokanovski” (PK 8219);

- në veri nga hamami "Deboj" ku kthehet dhe lëviz në drejtim të jug-lindjes përgjatë boshtit të rrugës "Ilo Xhokanovski" deri te pika e prerjes me drejtim kah boshti i rrugës "Prohor Pçinski" (PK 8149), atje kthen dhe vazhdon në drejtim të lindjes përgjatë boshtit të rrugës "Prohor Pçinski" (PK 8149) dhe pastaj kthen dhe lëviz përgjatë boshtit të krahut të saj juglindor (PK 8192/2) deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Sremska" (PK 8172) ku kthen dhe vazhdon në drejtim të jugperëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Sremska" deri te pika e prerjes me rrugën "Zhikica Jovanoviq - Shapac" (PK 8372), kthen dhe lëviz në drejtim të lindjes përgjatë boshtit të rrugës "Zhikica Jovanoviq – Shapac" deri te pika e prerjes në krahun verior të rrugës "Aleksandar Turunxhiev" (PK 8629), atje kthen dhe lëviz në drejtim të jugut përgjatë boshtit të atij krahut deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "15 Maj" (PK 99999/7), përsëri kthen dhe lëviz në drejtim të lindjes përgjatë boshtit të rrugës "15 Maj" deri te pika e prerjes në drejtim të atij boshti të rrugës "Prilepska" (PK 1) ku kthen dhe lëviz në drejtim të jugut përgjatë boshtit të rrugës "Prilepska", vazhdon më pas në drejtim të njëjtë përmes krahut verior në bulevardin "1 Maj" (PK 19358) dhe përmes lumit Dragor (PK 19249) përgjatë boshtit të urës Te Sali deri në pjesën jugore të asaj ure si pjesë e rajonit të KK Manastir 4. Pastaj, kufiri vazhdon në rajonin e KK Manastir 3, edhe atë nga pika jugore e boshtit të urës Te Sali në drejtim të jugut përmes krahut jugor të bulevardit "1 Maj" (PK 19335) dhe pastaj përmes boshtit të rrugës "4 Nëntor" (PK 19378) deri te pika e prerjes në drejtim të boshtit të rrugës "Blazhe Roguzinarot" (PK 8842) ku kthen dhe lëviz në drejtim të perëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Blazhe Roguzinarot" deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "2 Gusht" (PK 99999/28), atje kthen dhe lëviz në drejtim të jugut përgjatë boshtit të rrugës "2 Gusht" deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Gjuro Gjakoviq" (PK 99999/28), prej atje vazhdon në drejtim të jug-perëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Gjuro Gjakoviq" deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Nikolla Teslla" (PK 99999/27) në pjesën jugore të krahut verior të asaj rruge dhe nga ajo pikë jugperëndim nga pika e prerjes me boshtin e rr. "Jane Sandanski" (PK 99999/30), kthen në drejtim të jugut dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës "Jane Sandanski" deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Boris Kidriç" (PK 19384), prej ku vazhdon në drejtim të juglindjes përgjatë boshtit të krahut jugor të rrugës "Nikolla Teslla" (PK 12135) me kthesë lakore në drejtim të jugut deri te pika e prerjes të rrugës "Mihajlo Bajoxhiev" (PK 12150), vazhdon përgjatë boshtit të asaj rruge në drejtim të jugut deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Sollunska" (PK 99999/6), atje kthen në drejtim të veri-perëndimit dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës "Sollunska" deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Vardarska" ku kthen në drejtim të jugut dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës "Vardarska" (PK 16726/2) deri te pika e prerjes me boshtin e krahut perëndimor të rrugës "Ivo Ribar Lola" (PK 16703), prej nga vazhdon me kthim lakor përgjatë boshtit të krahut jugor të rrugës "Ivo Ribar Lola" (PK 16703) në jug deri te pika e prerjes me rrugën "Partizanska" (PK 19424/1) si pikë e prerjes me kufirin jugor të të mirës;

- Në jug kufiri fillon në rajonin e KK Manastir 1-2, nga pika e prerjes me kufirin lindor të të mirës dhe lëviz në drejtim të perëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Partizanska" (PK 19424/1) deri te pika e prerjes me drejtim të përcaktuar në mënyrë paralele me kufirin jug-perëndimor të PK 16699 në distancë prej 10m prej saj si pikë prerje me kufirin perëndimor të të mirës;

- Në perëndim kufiri fillon me rajonin e KK Manastir 1-2, nga pika e prerjes me kufirin jugor të të mirës dhe vazhdon në rajonin e KK Manastir 3 duke lëvizur në drejtim të veri-perëndimit në pjesën e PK 16698 në distancë prej 10 metrash paralelisht me gjithë kufirin jug-perëndimor të PK 16699 deri te kufiri jugor i KP 16692, pastaj nëpër kufirin jugor dhe lindor të PK 16692 deri te pika e prerjes në drejtim të kufirit lindor të asaj PK me boshtin e rrugës "Pitu Guli" (PK 19440), prej nga vazhdon të lëvizë në drejtim të veri-lindjes përgjatë boshtit të rrugës "Pitu Guli" dhe përmes rrugës "Kliment Ohridski" (PK 99999/7) pastaj përsëri përgjatë boshtit të krahut të rrugës "Pitu Guli" (PK 16656) deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Sollunska" (PK 19393), atje kthen në drejtim të perëndimit dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës "Sollunska" deri te pika e prerjes me boshtin e krahut të rrugës "Stiv Naumov" (PK 12345), vazhdon përgjatë

boshtit të atij krahu, e pret rrugën "Kliment Ohridski" (PK 19395) dhe lëviz në drejtim të perëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Stiv Naumov" (PK 19407) deri te pika e prerjes me boshtin e krahut të rrugës "Stiv naumov" (PK 13371), kthen dhe lëviz në drejtim të jugut përgjatë boshtit të asaj rruge deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Sollunska" (PK 19393) kthen dhe lëviz nëpër rrugën "Sollunska" në drejtim të perëndimit deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Stevo Patako" (PK 13383/2) atje kthen dhe lëviz në drejtim të veriperëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Stevo Patako" deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Stiv Naumov" (PK 19407), vazhdon në drejtim të veri- perëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Stiv Naumov" në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Hristo Botev" (PK 19403), kthen në drejtim të veri-lindjes përgjatë boshtit të rrugës "Hristo Botev" deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Pepi Puple" (PK 19401), vazhdon përgjatë boshtit të asaj rruge deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Mara Josifova" (PK 12733), lëviz përgjatë boshtit të rrugës "Mara Josifova" në drejtim të perëndimit deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Peco Bozhinovski" (PK 12706/2), atje kthen në drejtim të veriperëndimit dhe lëviz përgjatë boshtit të asaj rruge deri te pika e kthimit me boshtin të rrugës "Abdul Kerim Pasha" (PK 12706/1) prej nga kthen dhe lëviz në drejtim të veri perëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Abdul Kerim – pasha" me kthesë lakore deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Car Samoil" (PK 19400) vazhdon përmes asaj rruge në drejtim të veriut të rrugës "Trifun Panovski" (PK 99999/23) e pret rrugën "Ohridska" (PK 99999/23) dhe pastaj në drejtim të veriut lëviz përgjatë boshtit të rrugës "Trifun Panovski" (PK 7747) deri te pika e prerjes me kufirin jugor të bulevardit "1 Maj" (PK 19335) te lidhja me kufirin perëndimor të PK 7746 prej atje kthen në drejtim të veriut dhe lëviz nëpër kufirin jugor të bulevardit "1 Maj" (PK 19335) deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Sveti Naum" (PK 6287) kthen në drejtim të veriut dhe lëviz përmes bulevardit (PK 19335) deri te pika e prerjes me boshtin e "Crn Most" në pjesën jugore të saj. Nga ajo pikë kufiri vazhdon në rajonin e KK Manastir 4, fillimisht përgjatë boshtit të "Cërn Most" të lumit Dragor (PK 19249) në drejtim të veriut dhe përmes pjesës së rrugës "Deveani" (PK 19336), dhe pastaj në drejtim të verilindjes përgjatë boshtit të rrugës "Dragorska" (PK 99999/21) deri te pika e prerjes me boshtin e krahut verior dhe juglindor të asaj rruge si pikë e prerjes me kufirin verior të të mirës;

- Në veri kufiri fillon nga pika e prerjes me kufirin perëndimor të asaj të mire në rajonin e KK Manastir 4 dhe lëviz përgjatë boshtit të krahut juglindor të rrugës "Dragorska" (PK 99999/21) deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "7 Brigada" (PK 99999/22), prej ku vazhdon në drejtim të verilindjes përgjatë boshtit të asaj rruge deri te pika e prerjes me rrugën "Mirçe Acev" (PK 99999/23) kthen në drejtim të veriut përgjatë boshtit të asaj rruge deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Borka Talev" (PK 99999/24), vazhdon përgjatë boshtit të rrugës "Borka Talev" dhe më tej në boshtin e krahut nga rruga Dimitar Vllahov (PK 99999/25) përmes rrugës "Jane Sandanski" (PK 19343) dhe pastaj përgjatë boshtit të rrugës "Dimitar Vllahov" (PK 19292) deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Dimitrije Tucoviq" (PK 99999/16) përgjatë boshtit të asaj rruge në drejtim të juglindjes dhe pjesa e rrugës "Sremska Mitrovica" (PK 2787/1) deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Sveti Naum" (PK 99999/14) dhe përgjatë boshtit të pjesës së rrugës "Sveti Naum" deri te pika e prerjes me kufirin lindor të të mirës si pikë përfundimtare e përshkrimit të kufijve të Qendrës së Vjetër të Qytetit të Manastirit.

Neni 4

(1) Në përbërje të Qendrës së Vjetër të Qytetit të Manastirit ka katër komplekse urbane (në tekstin e mëtejme: komplekse urbane), si vijojnë:

- Kompleksi Urban – 1: "Çarshia e Vjetër",
- Kompleksi Urban – 2: "Shirok Sokak",
- Kompleksi Urban – 3: "Dërven Pazar" dhe
- Kompleksi Urban – 4: "Bulevard".

(2) Në Kompleksin Urban - 1: "Çarshia e Vjetër" ekzistojnë edhe e mira e mbrojtur e veçantë - tërësia monumentale "Çarshia e Vjetër e Manastirit" dhe të mira tjera të patundshme të mbrojtura si trashëgimi kulturore në bazë të aktit për mbrojtje në pajtim me ligjin.

(3) Në Kompleksin Urban - 2: "Shirok Sokak" ekzistojnë edhe e mira e mbrojtur në mënyrë të veçantë - tërësia monumentale "Rruga ambientale Marshall Tito" (rruga "Shirok Sokak") dhe të mira të tjera të patundshme të mbrojtura si trashëgimi kulturore në bazë të aktit për mbrojtje në pajtim me ligjin.

(4) Në Kompleksin Urban - 3: "Dërven Pazar" dhe Kompleksin Urban - 4: "Bulevard" ekzistojnë edhe patundshmëri të tjera të veçanta të mbrojtura si trashëgimi kulturore në bazë të aktit për mbrojtje në pajtim me ligjin.

(5) Komplekset urbane në "Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit" kanë sipërfaqe prej:

1. Kompleksi Urban – 1: "Çarshia e Vjetër" 17,19 ha,
2. Kompleksi Urban – 2: "Shirok Sokak" 33,12 ha,
3. Kompleksi Urban – 3: "Dërven Pazar" 27,68 ha dhe
4. Kompleksi Urban – 4: "Bulevard" 31,23 ha.

(6) Komplekset Urbane në "Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit", secili prej tyre veçmas, e përfshijnë hapësirën mes këtyre dy pikave përfundimtare:

1. Kompleksi Urban – 1: "Çarshia e Vjetër"
 - Pika më lindore: $X = 41^{\circ} 01' 52.50''$ $Y = 21^{\circ} 20' 29.51''$
 - Pika më jugore: $X = 41^{\circ} 01' 45.66''$ $Y = 21^{\circ} 20' 14.45''$
 - Pika më perëndimore: $X = 41^{\circ} 01' 52.77''$ $Y = 21^{\circ} 20' 04.02''$
 - Pika më veriore: $X = 41^{\circ} 02' 02.40''$ $Y = 21^{\circ} 20' 17.60''$
2. Kompleksi Urban – 2: "Shirok Sokak"
 - Pika më lindore: $X = 41^{\circ} 01' 34.70''$ $Y = 21^{\circ} 20' 25.66''$
 - Pika më jugore: $X = 41^{\circ} 01' 23.52''$ $Y = 21^{\circ} 20' 09.18''$
 - Pika më perëndimore: $X = 41^{\circ} 01' 49.25''$ $Y = 21^{\circ} 19' 56.05''$
 - Pika më veriore: $X = 41^{\circ} 01' 52.80''$ $Y = 21^{\circ} 20' 04.00''$
3. Kompleksi Urban – 3: "Dërven Pazar" dhe
 - Pika më lindore: $X = 41^{\circ} 01' 38.55''$ $Y = 21^{\circ} 20' 03.64''$
 - Pika më jugore: $X = 41^{\circ} 01' 30.40''$ $Y = 21^{\circ} 19' 55.03''$
 - Pika më perëndimore: $X = 41^{\circ} 01' 45.35''$ $Y = 21^{\circ} 19' 31.82''$
 - Pika më veriore: $X = 41^{\circ} 01' 51.26''$ $Y = 21^{\circ} 19' 32.22''$
4. Kompleksi Urban – 4: "Bulevard"
 - Pika më lindore: $X = 41^{\circ} 01' 59.69''$ $Y = 21^{\circ} 20' 13.63''$
 - Pika më jugore: $X = 41^{\circ} 01' 48.19''$ $Y = 21^{\circ} 19' 49.12''$
 - Pika më perëndimore: $X = 41^{\circ} 01' 53.46''$ $Y = 21^{\circ} 19' 24.35''$
 - Pika më veriore: $X = 41^{\circ} 02' 06.13''$ $Y = 21^{\circ} 20' 04.54''$.

Neni 5

(1) Kufijtë e Komplekseve urbane janë:

1. Kompleksi Urban "Çarshia e Vjetër" në Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit" i ka këto kufij:

- Verilindje: kufiri fillon nga rajoni i KK Manastir 4, në veri të hamamit "Deboj" nga pika prerëse e boshtit të rrugës "Ivan Millutinoviç" (PK 19302) me boshtin e rrugës "Ilo Xhokanovski" (PK 8219), si pikë e nisjes e kufirit veriperëndimor të Kompleksit urban - 1: "Çarshia e Vjetër", dhe lëviz sipas pjesës nga kufiri lindor i tërësisë së përmendoreve "Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit", respektivisht së pari në drejtim të juglindjes përgjatë boshtit të rrugës "Ilo Xhokanovski" deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Prohor Pçinski" (PK 8149), pastaj kthen dhe vazhdon drejt në drejtim të lindjes përgjatë boshtit të rrugës "Prohor Pçinski" (PK 8149), dhe pastaj kthen dhe lëviz përgjatë boshtit të krahut të saj juglindor (PK

8192/2) deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Sremska" (PK 8172) ku kthen dhe vazhdon në drejtim të jugperëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Sremska" deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Zhikica Jovanoviç- Shapac" (PK 8372), kthen dhe lëviz në drejtim të lindjes përgjatë boshtit të rrugës "Zhikica Jovanoviç – Shapac" deri te pika e prerjes me krahun verior të rrugës "Aleksandar Turunxhev" atje kthen dhe lëviz në drejtim të jugut përgjatë boshtit të atij krahu deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "15 Maj" (PK 99999/7), përkatësisht kthen dhe lëviz në drejtim të lindjes deri te boshti i rrugës "15 Maj" deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Prilepska" (PK 1), ku kthen dhe lëviz në drejtim të jugut përgjatë boshtit të rrugës "Prilepska" duke vazhduar më tej në drejtim të njëjtë nëpër krahun verior të bulevardit "1 Maj" (PK 19358) dhe përmes lumit Dragor (PK 19249) përgjatë boshtit të urës Te Sali deri te ana jugore e urës, prej nga kufiri vazhdon në rajonin e KK Manastir 3, në drejtim të jugut përmes krahut jugor të bulevardit "1 Maj" (PK 19335) dhe pastaj përgjatë boshtit të rrugës "4 Nëntor" (PK 19378) deri te pika e prerjes me boshtin e rrugës "Blazhe Roguzinarot" (PK 8842) si pikë e prerjes me kufirin juglindor të Kompleksit urban -1: "Çarshia e Vjetër";

- Juglindje: kufiri fillon në rajonin KK Manastir 3, nga pika e prerjes me kufirin verilindor të Kompleksit Urban – 1: "Çarshia e Vjetër", si pikë e nisjes e kufirit juglindor të atij Kompleksi Urban, dhe lëviz nëpër një pjesë të kufirit lindor të tërësisë monumentale "Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit", përkatësisht së pari në drejtim të perëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Blazhe Roguzinarot" (KP 8842) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "2 Gushti" (KP 99999/28), pastaj kthen dhe lëviz në drejtim të jugut përgjatë boshtit të rrugës "2 Gushti" deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Gjuro Gjakoviç" (KP 9999/28), së këtijmi vazhdon në drejtim të jugperëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Gjuro Gjakoviç" deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Nikolla Teslla" (KP 99999/27) në pjesën jugore të krahut veriore të asaj rruge dhe prej asaj pike në jugperëndim deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Jane Hristovski" (KP 99999/30) si pikë e prerjes me kufirin jugperëndimor të Kompleksit Urban - 1: "Çarshia e Vjetër";

- Jugperëndim: kufiri fillon në rajonin KK Manastir 3, nga pika e prerjes me kufirin juglindor të Kompleksit Urban – 1: "Çarshia e Vjetër", si pikë e nisjes në kufirin jugperëndimor të atij Kompleksi Urban dhe lëviz në drejtim të veriperëndimit përgjatë boshtit të pjesës së rrugës "Jane Hristovski" dhe më tej nëpër pjesën e rrugës "Ruzvelltova" (KP 11452) vazhdon përgjatë boshtit të rrugës "Dobrivoje Radosavljeniq" (KP 9059), deri në pikën e prerjes me boshtin e krahut jugore në bulevardin "1 Maj" (KP 19335), kthen aty dhe lëviz në drejtim të perëndimit nëpër boshtin e atij krahu në bulevardin "1 Maj" deri në prerjen me drejtimin e boshtit të urës në perëndim të Bezistenit si pikë e prerjes me kufirin veriperëndimor të Kompleksit Urban – 1: "Çarshia e Vjetër";

- Veriperëndim: kufiri fillon në rajonin KK Manastir 3, nga pika e prerjes me kufirin jugperëndimor të Kompleksit Urban – 1: "Çarshia e Vjetër", si pikë e nisjes e kufirit veriperëndimor të atij Kompleksi Urban, dhe lëviz nëpër zonën e KK Manastir 4, së pari në drejtim të veriut përtej lumit Dragor (KP 19249) përgjatë boshtit të urës në perëndim të Bezistenit dhe një pjesë e krahut verior të bulevardit "1 Maj" (KP 99999/26), kurse pastaj kthen dhe vazhdon në drejtim të veriperëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Ivan Millutinoviç" (KP 19302) deri në pikën e prerjes me kufirin verilindor të Kompleksit Urban – 1: "Çarshia e Vjetër" si pikë përfundimtare e përsëkrimit të kufijve të atij Kompleksi Urban në tërësinë monumentale "Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit".

2. Kompleksi Urban "Shirok Sokak" në "Qendrën e Vjetër e Qytetit të Manastirit" i ka kufijtë në vijim:

- Lindje: kufiri fillon në rajonin e KK Manastir 3, prej pikës së prerjes të boshtit të krahut jugor të bulevardit "1 Maj" (KP 19335) dhe boshtit të rrugës "Dobrivoje Radosavljeviç" (KP 9059), në jug prej urës në lindje prej Bezistenit, si pikë e nisjes e kufirit lindor të Kompleksit Urban – 2: "Shirok Sokak", dhe lëviz në drejtim të juglindjes nëpër kufirin jugperëndimor të

Kompleksit Urban – 1: “Çarshia e Vjetër”, përkatësisht përgjatë boshtit të rrugës “Dobrivoje Radosavljeviq” (KP 9059) dhe më tutje nëpër pjesën e rrugës “Ruzvelltova” (KP 11452) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Jane Hristovski” (KP 99999/30), si pikë e prerjes me kufirin juglindor të Kompleksit Urban – 1: “Çarshia e Vjetër”, aty kthen dhe vazhdon nëpër një pjesë të kufirit lindor të tërësisë monumentale “Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit”, përkatësisht së pari në drejtim të jugut përgjatë boshtit të rrugës “Jane Hristovski” deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Boris Kidriç” (KP 19384), kurse pastaj në drejtim të juglindjes përgjatë boshtit të krahut jugor të rrugës “Nikolla Teslla” (KP 12135) me kthim harkor në drejtim të jugut deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Mihajlo Bojaxhiev” (KP 12150), vazhdon përgjatë boshtit të asaj rruge në drejtim të jugut deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Sollunska” (KP 99999/6), aty kthen në drejtim të verilindjes dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës “Sollunska” deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Vardarska” ku kthen në drejtim të jugut dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës “Vardarska” (KP 16726) deri në pikën e prerjes me boshtin e krahut perëndimor të rrugës “Ivo Ribar Lola” (PK 16703), prej ku vazhdon me kthesë harkore përgjatë boshtit të krahut jugore të rrugës “Ivo Ribar Lola” (PK 16703) dhe më tej në jug të rajonit të KK Manastir 1-2 deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Partizanska” (PK 19424/1) si pikë e prerjes me kufirin jugor të të mirës, përkatësisht kufirit jugor të Kompleksit Urban – 2: “Shirok Sokak”;

- Jug: kufiri fillon në rajonin KK Manastir 1-2, nga pika e prerjes me kufirin lindor të të mirës, përkatësisht kufirin lindor të Kompleksit Urban – 2: “Shirok Sokak”, si pikë e nisjes e kufirit jugor të atij Kompleksi Urban, dhe lëviz përgjatë kufirit jugor të tërësisë monumentale “Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit” në drejtim të perëndimit, përkatësisht përgjatë boshtit të pjesës së rrugës “Partizanska” (PK 19424/1) deri në pikën e prerjes me kufirin perëndimor të të mirës si pikë e prerjes me kufirin perëndimor të Kompleksit Urban -2: “Shirok Sokak”;

- Perëndim: kufiri fillon në rajonin KK Manastir 1-2, nga pika e prerjes me kufirin jugor të të mirës, përkatësisht kufirin jugor të Kompleksit Urban – 2: “Shirok Sokak”, si pikë e nisjes e kufirit perëndimor të atij kompleksi urban, dhe lëviz përgjatë rajonit të KK Manastir 3 përgjatë një pjese të kufirit perëndimor të tërësisë monumentale “Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit”, përkatësisht së pari në drejtim të veriperëndimit në pjesë të PK 16698 në distancë prej 10 metrave paralelisht me tërë kufirin jugperëndimor të PK 16699 deri në kufirin jugor të PK 16692, ndërsa pastaj nëpër kufirin jugor dhe lindor të PK 16692 deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Pitu Guli” (PK 19440), prej ku do të vazhdojë të lëvizë përgjatë boshtit të rrugës “Pitu Guli” dhe përgjatë rrugës “Kliment Ohridski” (PK 99999/7) më tej përsëri përgjatë boshtit të krahut të rrugës “Pitu Guli” (PK 16656) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Sollunska” (PK 19393), aty kthen në drejtim të perëndimit dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës “Sollunska” deri në pikën e prerjes me boshtin e krahut së rrugës “Stiv Naumov” (PK 12345) dhe vazhdon përgjatë boshtit të atij krahu deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Kliment Ohridski” (PK 19395) ku braktis kufirin perëndimor të të mirës dhe vazhdon në drejtim të veriut nëpër qendër, duke lëvizur së pari përgjatë boshtit të rrugës “Kliment Ohridski” (PK 19395) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Leninova” (PK 19384), kurse pastaj kthen në drejtim të perëndimit dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës “Leninova” deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Cirili dhe Metodi” (PK 99999/25), aty kthen në drejtim të verilindjes dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës “Cirili dhe Metodi” deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Sllavko Llumbarkovski” (PK 19337) kur kthen në drejtim të veriperëndimit dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës “Sllavko Llumbarkovski” dhe më tutje përtej zgjerimit të rrugës “Sterjo Georgiev” (PK 19398), me kthim në drejtim të veriut, vazhdon përgjatë boshtit të krahut verior të asaj rruge (KP 7933) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Car Samoil” (KP 19400) si pikë e prerjes me kufirin verior të Kompleksit Urban – 2: “Shirok Sokak”;

- Veri: kufiri fillon në rajonin KK Manastir 3, nga pika e prerjes me kufirin perëndimor të Kompleksit Urban – 2: “Shirok Sokak”, si pikë e nisjes e kufirit verior të atij Kompleksi Urban, dhe lëviz në drejtim të verilindjes përgjatë boshtit të rrugës “Car Samoil” (KP 19400) dhe më tej

përgjatë boshtit të rrugës "Petar Petroviq – Njegosh" (KP 7992) deri në pikën e prerjes së boshtit të krahut jugor të bulevardit "1 Maj" (KP 19335), duke vazhduar në drejtim të lindjes përgjatë boshtit të atij krahut të bulevardit "1 Maj" deri në pikën e prerjes me kufirin veriperëndimor të Kompleksit Urban – 1: "Çarshia e Vjetër" edhe më tej në drejtim të lindjes në pjesë të bulevardit "1 Maj", që paraqet pjesë të kufirit jugperëndimor të Kompleksit Urban – 1: "Çarshia e Vjetër", deri në pikën e prerjes të kufirit lindor të Kompleksit Urban – 2: "Shirok Sokak" si pikë përfundimtare e përshkrimit të kufijve të atij Kompleksi Urban në tërësinë monumentale "Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit".

3. Kompleksi Urban "Dërven Pazar" në "Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit" i ka kufijtë në vijim:

- Lindje: kufiri fillon në rajonin KK Manastir 3, nga pika e prerjes me kufirin perëndimor dhe verior të Kompleksit Urban – 2: "Shirok Sokak", përkatësisht prerja e boshtit të rrugës "Car Samoil" (KP 19400) dhe krahut verior i rrugës "Sterjo Georgiev" (KP 7933), si pikë e nisjes e kufirit lindor të Kompleksit Urban – 3: "Drven Pazar", dhe shtrihet në drejtim të jugut nëpër pjesën më të madhe të kufirit perëndimor të Kompleksit Urban - 2: "Shirok Sokak" si kufi i përbashkët, përkatësisht së pari përgjatë boshtit të krahut perëndimor të rrugës "Sterjo Georgiev" KP(7933) dhe më tej përgjatë zgjerimit të rrugës "Sterjo Georgiev" (KP 19398), pastaj, me kthesën në drejtim të juglindjes përgjatë boshtit të rrugës "Sllavko Llumbarkovski" (KP 19337), vazhdon në drejtim të jugperëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Cirili dhe Metodi" (KP 00000/25), pastaj në drejtim të lindjes përgjatë boshtit të rrugës "Leninova" (KP 19384) dhe në drejtim të jugperëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Kliment Ohridski" (KP 19395) deri në pikën e prerjes së boshtit të rrugës "Stiv Naumov" (KP 19407) si pikë e prerjes me kufirin perëndimor të të mirës, që paraqet pikë të prerjes me kufirin jugor të Kompleksit Urban - 3: "Dërven Pazar":

- Jug: kufiri fillon në rajonin KK Manastir 3, nga pika e prerjes me kufirin lindor të Kompleksit Urban – 3: "Dërven Pazar", si pikë e nisjes e kufirit jugor të atij Kompleksi Urban, dhe lëviz në drejtim të perëndimit nëpër pjesën e kufirit perëndimor të tërësisë monumentale "Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit", përkatësisht së pari përgjatë boshtit të rrugës "Stiv Naumov" (KP 19407) deri në pikën e prerjes me boshtin në degën e rrugës "Stiv Naumov" (KP 13371), pastaj përgjatë boshtit të rrugës "Sollunska" (KP 19393) ku kthehet në drejtim të perëndimit dhe vazhdon përgjatë boshtit të rrugës "Sollunska" deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Stevo Patako" (KP 13382/2) si pikë e prerjes me kufirin perëndimor të Kompleksit Urban – 3: "Dërven Pazar":

- Perëndim: kufiri fillon në rajonin KK Manastir 3, nga pika e prerjes me kufirin jugor të Kompleksit Urban – 3: "Dërven Pazar", si pikë e nisjes e kufirit perëndimor të atij Kompleksi Urban, dhe lëviz përgjatë pjesës më të madhe të kufirit perëndimor të tërësisë monumentale "Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit", përkatësisht së pari në drejtim të verilindjes përgjatë boshtit të rrugës "Stevo Patako" (KP 13383/2) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Stiv Naumov" (KP 19407), pastaj kthen në drejtim të veriperëndimit dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës "Stiv Naumov" deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Hristo Botev" (KP 19403) ku kthen në drejtim të verilindjes përgjatë boshtit të rrugës "Hristo Botev" deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Pepi Puple" (KP 19401), vazhdon përgjatë boshtit të asaj rruge deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Mara Josifova" (KP 12706/2), aty kthen në drejtim të verilindjes dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës "Peco Bozhinovski" (KP 12706/1), prej ku kthen dhe lëviz në drejtim të veriperëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Abdul Kerim-Pasha" me kthesë deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Car Samoil" (KP 19400), duke vazhduar nëpër atë rrugë në drejtim të veriut përgjatë boshtit të pjesës jugore të rrugës "Trifun Panovski" (KP 99999/23) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Ohridska" (KP 99999/33), si pikë e prerjes me kufirin verior të Kompleksit Urban - 3 "Dërven Pazar";

- Veri: kufiri fillon në rajonin KK Manastir 3, nga pika e prerjes me kufirin perëndimor të Kompleksit Urban – 3: “Dërven Pazar”, si pikë e nisjes e kufirit verior të atij Kompleksi Urban, dhe lëviz në drejtim të lindjes, së pari përgjatë boshtit të rrugës "Ohridska" (KP 99999/33) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Car Samoil" (KP 19400), kurse pastaj përgjatë boshtit të asaj rruge deri në pikën e prerjes me boshtin e krahut verior të rrugës “Sterjo Georgiev” (KP 7933) si pikë e prerjes me kufirin lindor të Kompleksit Urban – 3: “Dërven Pazar” dhe pikë përfundimtare e përshkrimit të kufijve të atij Kompleksi Urban në tërësinë monumentale “Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit”.

4. Kompleksi Urban “Bulevard” në “Qendrën e Vjetër e Qytetit të Manastirit” i ka kufijtë në vijim:

- Verilindje: kufiri fillon në rajonin e KK Manastir 4, prej pikës së prerjes së boshteve të rrugëve “Dimitar Vllahov” (KP 19292) dhe “Dimitrije Tucoviq” (KP 99999/16), si dhe pikës së nisjes në kufirin verilindor të Kompleksit Urban - 4: “Bulevard”, dhe lëviz në drejtim të juglindjes nëpër një pjese të vogël të kufirit verior të të mirës , përkatësisht përgjatë boshtit të rrugës “Dimitrije Tucoviq”, pjesë të rrugës “Sremska Mitrovica” (KP 2787/1) dhe pjesë të rrugës "Shën Naum” (KP 99999/14) deri në pikën e prerjes me kufirin lindor të të mirës ku kthen në drejtim të jugut dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës "Shën Naum”, si pjesë e kufirit lindor të tërësisë monumentale “Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit”, deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Ivan Millutinoviq ” (KP 19302) si pikë e prerjes me kufirin juglindor të Kompleksit Urban – 4: Bulevard”;

- Juglindje: kufiri fillon në rajonin KK Manastir 4, nga pika e prerjes me kufirin verilindor të Kompleksit Urban – 4: “Bulevard”, si pikë e nisjes e kufirit juglindor në atë Kompleks Urban, dhe shtrihet në drejtim të jugperëndimit përgjatë kufirit veriperëndimor të Kompleksit Urban – 1: “Çarshia e Vjetër” si kufi i përbashkët, përkatësisht përgjatë boshtit të rrugës “Ivan Millutinoviq ” (KP 19302) dhe me kthesë në drejtim të jugut përtej lumit Dragor (KP 19249) përgjatë boshtit të urës në perëndim prej Bezistenit dhe më tej në rajonin KK Manastir 3 deri në pikën e prerjes me boshtin e krahut jugore të bulevardit "1 Maj" si pikë e prerjes së kufirit jugperëndimor dhe veriperëndimor të Kompleksit Urban - 1: Çarshia e Vjetër " me kufirin verior të Kompleksit Urban – 2: “Shirok Sokak” dhe pikë e prerjes me kufirin jugor të Kompleksit Urban - 4: Bulevard”;

- Jug: kufiri fillon në rajonin KK Manastir 3, nga pika e prerjes me kufirin juglindor të kompleksit Urban – 4: “Bulevard”, si pikë e nisjes e kufirit jugor në atë Kompleks urban, dhe shtrihet së pari në drejtim të jugperëndimit përgjatë një pjese prej kufirit verior të Kompleksit Urban – 2: “Shirok Sokak”, përkatësisht pjesë e krahut jugore të bulevardit "1 Maj” (KP 19335), boshti i rrugës “Petar Petrovqi-Njegoshi” (KP 7992) dhe boshti i një pjese të rrugës “Car Samoil” (KP 19400) deri në pikën e prerjes me kufirin perëndimor të Kompleksit Urban -2: “Shirok Sokak”, prej ku vazhdon në drejtim të perëndimit me kufirin verior të Kompleksit Urban - 3: “Dërven Pazar”, përkatësisht përgjatë boshtit të rrugës “Car Samoil” (KP 19400) dhe boshtin e rrugës “Ohridska” (KP 99999/33) deri në pikën e prerjes me kufirin perëndimor të tërësisë monumentale “Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit” si pikë e prerjes me kufirin perëndimor të Kompleksit Urban – 4: Bulevard”;

- Veri: kufiri fillon në rajonin e KK Manastir 3, nga pika e prerjes me kufirin jugor të Kompleksit Urban - 4: "Bulevard", si pikë e nisjes e kufirit perëndimor të atij Kompleksi Urban, dhe lëviz përgjatë pjesës së kufirit perëndimor të tërësisë monumentale "Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit", përkatësisht fillimisht në drejtim të veriut përgjatë boshtit të pjesës veriore të rrugës "Trifun Panovski" (PK 7747) deri në pikën e prerjes me kufirin jugor të krahut jugor të bulevardit "1 Maj" (PK 19335) te lidhja me kufirin perëndimor të PK 7746, pastaj në drejtim të perëndimit përgjatë kufirit jugor në atë degë të bulevardit "1 Maj" deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Stiv Naumov" (PK 6287) ku kthen në drejtim të veriut dhe vazhdon në rajonin e KK Manastir 4, përmes lumit Dragor (PK 19249) përgjatë boshtit të "Crn Most"

dhe më tutje në drejtim të veriut përmes pjesës së rrugës "Dragorska" (PK 99999/21) deri në pikën e prerjes me boshtet e krahut verior dhe juglindor të asaj rruge si pikë e prerjes me kufirin verior të tërësisë monumentale "Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit" dhe kufirin verior të Kompleksit Urban - 4: "Bulevard";

- Veri: kufiri fillon në rajonin e KK Manastir 4, nga pika e prerjes me kufirin verior të Kompleksit Urban - 4: "Bulevard", si pikë e nisjes e kufirit verior të atij Kompleksi Urban, dhe lëviz përgjatë kufirit verior të tërësisë monumentale "Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit", përkatësisht së pari nëpër krahun juglindor të rrugës "Dragorska" (PK 99999/21), e pastaj në drejtim të verilindjes nëpër boshtin e rrugës "7 Brigada (PK 99999/22) deri në pikën e prerjes me Boshtin e rrugës "Mirçe Acev" (PK 99999/23) ku kthen në drejtim të veriut përgjatë boshtit të asaj rruge deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Borka Talev" (PK 99999/24), duke vazhduar përgjatë boshtit të asaj rruge në drejtim të verilindjes edhe më tutje përgjatë boshtit të rrugës "Dimitar Vllahov" (PK 19292) deri në pikën e prerjes me rrugën "Dimitrije Tucoviq" (PK 99999/16) si pikë e prerjes me kufirin verilindor të Kompleksit urban - 4: "Bulevard" dhe pika përfundimtare e përshkrimit të kufijve të atij Kompleksi Urban në tërësinë monumentale "Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit".

(2) Komplekset Urbane, secili prej tyre në kuadër të kufijve të tyre, sipas komunave kadastrale të cilave u përkasin, i përfshijnë në tërësi ose pjesërisht parcelat kadastrale të poshtëshënuara (PK):

përgjatë boshtit të kësaj rruge deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Nikolla Teslla" (PK 12135), vazhdon me kthim të lehtë në drejtim të veriperëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Nikolla Teslla" deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Boris Kidriç" (PK 19384) dhe më tutje përgjatë boshtit të rrugës "Jane Hristovski" (PK 99999/30) deri në pikën e prerjes me drejtimin e boshtit të rrugës "Gjuro Gjakoviq", kthen në drejtim të verilindjes dhe përmes pjesës jugore të krahut verior të rrugës "Nikolla Teslla" (PK 99999/27) vazhdon përgjatë boshtit të rrugës "Gjuro Gjakoviq" (PK 99999/28) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "2 Gushti" (PK 99999/28), kthen në drejtim të veriut dhe lëviz përgjatë boshtit të kësaj rruge deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Bllazhe Roguzinarot" (PK 8842) si pikë e prerjes me kufirin verior të zonës kontaktuese;

- në veri kufiri fillon nga pika e prerjes me kufirin perëndimor të zonës kontaktuese dhe lëviz në drejtim të juglindjes nëpër pjesën e kufirit lindor të të mirës, përkatësisht përgjatë boshtit të rrugës "Bllazhe Roguzinarot" (PK 8842) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "4 Nëntori" (PK 19378) ku kthen në drejtim të veriut dhe lëviz përgjatë boshtit të kësaj rruge dhe më tutje në drejtimin e njëjtë përmes krahut jugor të bulevardit "1 Maji" (PK 19335) dhe përgjatë boshtit të urës të Salli deri në pjesën e tij qendrore, përkatësisht përgjatë boshtit të shtratit të lumit Dragor (PK 19249), aty kthen në drejtim të juglindjes dhe lëviz përgjatë boshtit të shtratit të lumit si pjesë e kufirit të përbashkët me ZK "Jeni maalle", deri në pikën e prerjes me kufirin lindor të zonës kontaktuese, si pikë përfundimtare e përshkimit të kufirit të zonës kontaktuese "Karposh".

(5) Zona Kontaktuese "Zandan Kule" i ka këta kufij:

- në kufirin verilindor fillon nga pika e prerjes së boshtit të rrugës "Trifun Panovski" (PK 7747) me kufirin jugor në krahun jugor të bulevardit "1 Maji" (PK 19335) në afërsi të këndit jugperëndimor të PK 7746, si pikë e nisjes e kufirit verilindor të zonës kontaktuese, dhe lëviz në drejtim të jugut nëpër pjesën e kufirit perëndimor të të mirës, përkatësisht përgjatë boshtit të rrugës "Trifun Panovski" (PK 7747), e pret rrugën "Ohridska" (PK 99999/33) dhe vazhdon më tutje përgjatë boshtit të rrugës "Trifun Panovski" (PK 99999/23), kurse në drejtimin e njëjtë edhe përmes rrugës „Car Samoill" (PK 19400) dhe në mënyrë harkore përgjatë boshtit të rrugës "Abdul Kerim-Pasha" (PK 12706/1) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës „Peco Bozhinovski" (PK 12706/2), aty kthen në drejtim të jugut dhe lëviz pjesërisht përgjatë boshtit të kësaj rruge, deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Mara Josifova" (PK 12733), kthen në drejtim të lindjes dhe vazhdon përgjatë boshtit të kësaj rruge deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Pepi Puple" (PK 19401) të këndi juglindor në parkun "Sinan Bej" (PK 12734/1), kthen në drejtim të jugut dhe lëviz përgjatë boshtit të rrugës "Pepi Puple" deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Hristo Botev" (PK 19403), kthen në drejtim të jugperëndimit dhe lëviz përgjatë boshtit të kësaj rruge deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Stiv Naumov" (PK 19407), kthen në drejtim të juglindjes dhe lëviz përgjatë boshtit të kësaj rruge, me kthim drejt jugperëndimit përgjatë boshtit të rrugës "Stevo Patako" (PK 13383/2), pastaj drejt juglindjes përgjatë boshtit të rrugës "Sollunska" (19393) dhe drejt verilindjes përgjatë boshtit të krahut të rrugës "Stiv Naumov" (PK 13371), kthen në drejtim të lindjes duke vazhduar përgjatë boshtit të rrugës "Stiv Naumov" (PK 19407) dhe në vazhdim përmes rrugës "Kliment Ohridski" (PK 19395) më tutje nëpër krahun e rrugës "Stiv Naumov" (PK 12345) dhe në drejtim të lindjes përgjatë boshtit të rrugës "Sollunska" (PK 19393) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës "Pitu Guli" (PK 16656) si pikë e prerjes me kufirin juglindor të zonës kontaktuese;

- në juglindje kufiri fillon nga pika e prerjes me kufirin verilindor të zonës kontaktuese dhe lëviz në mënyrë harkore në drejtim të jugperëndimit nëpër pjesën e kufirit perëndimor të të mirës, përkatësisht nëpër boshtin e krahut të rrugës "Pitu Guli" (PK 16656), e pret rrugën "Kliment Ohridski" (PK 99999/7) dhe vazhdon në drejtim të jugperëndimit nëpër boshtin e rrugës "Pitu Guli" (PK 19440), deri në pikën e prerjes me boshtin e degës jugore të rrugës "Pitu Guli" (PK 16523) si pikë prerëse me kufirin jugperëndimor të zonës kontaktuese;

- në jugperëndim kufiri fillon nga pika e prerjes me kufirin jugperëndimor të zonës kontaktuese dhe lëviz në drejtim të veriut nëpër boshtin e rrugës “Pitu Guli” (PK 16523) dhe më tutje nëpër boshtin e rrugës “Krushevska” (PK 16576) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Hristo Uzunov” (16461) ku kthen në drejtim të perëndimit dhe lëviz nëpër atë rrugë me kthim drejt veriut deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Leinska” (PK 16446), atje kthen në drejtim të veriperëndimit, e pret rrugën “Niko Fundali” (PK 99999/8) dhe vazhdon nëpër boshtin e rrugës “Lerinska” (PK 99999/9), deri në pikën e prerjes me rrugën “Sollunska” (PK 19393), lëviz në drejtim të njëjtë nëpër boshtin e asaj rruge deri në kthimin drejt jugperëndimit te PK 13192 dhe më tutje deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Peco Bozhinovski” (PK 19408) te xhamia Hamza Bej, kthen në drejtim të verilindjes dhe lëviz nëpër boshtin e rrugës “Peco Bozhinovski”, deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Stiv Naumov” (PK 19407), kthen në drejtim të verilindjes dhe vazhdon nëpër boshtin e asaj rruge deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Car Samoil” (PK 19400) ku kthen në drejtim të veriut dhe lëviz nëpër rrugën “Stiv Naumov” (PK 6986), e pret rrugën “Ohridska” dhe vazhdon nëpër rrugën “Stiv Naumov” (PK 6287) deri në pikën e prerjes me kufirin jugor të krahut jugor të bulevardit “1 Maj” (PK 19335) si pikë prerëse me kufirin verior të zonës kontaktuese;

- në veri kufiri fillon nga pika prerëse me kufirin jugperëndimor të zonës kontaktuese dhe lëviz në drejtim të lindjes nëpër pjesën e kufirit perëndimor të së mirës, përkatësisht nëpër kufirin verior të rrugës “Sharplaninska” (PK 6252) dhe më tutje nëpër kufirin jugor të krahut jugor të bulevardit “1 Maj” (PK 19335) deri në pikën e prerjes me kufirin verilindor të zonës kontaktuese si pikë përfundimtare e përshkrimit të kufijve të zonës kontaktuese “Zandan Kule”.

(6) Zona kontaktuese “Park” i ka kufijtë, si vijon:

- në lindje kufiri fillon në zonën e KK Manastir 1-2, nga pika e prerjes në kufirin lindor dhe jugor të së mirës në boshtin e rrugës “Partizanska” (PK 19424/1), si pikë fillestare në kufirin lindor të zonës kontaktuese, dhe lëviz në drejtim të juglindjes nëpër boshtin e rrugës “Ivo Ribar Lola” (PK 19442) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës drejt stadiumit (PK 19454) si pikë prerëse me kufirin jugor të zonës kontaktuese;

- në jug kufiri fillon nga pika prerëse me kufirin lindor të zonës kontaktuese dhe lëviz në drejtim të perëndimit nëpër boshtin e rrugës drejt stadiumit (PK 19454) deri në pikën e prerjes me drejtimin e kufirit perëndimor të Shëtitores, përkatësisht rruga “Marshall Tito” (PK 17573/1), si pikë prerëse me kufirin perëndimor të zonës kontaktuese;

- në perëndim kufiri fillon nga pika prerëse me kufirin jugor të zonës kontaktuese dhe lëviz në drejtim të veriperëndimit nëpër kufirin perëndimor të Shëtitores, (PK 17573/1) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “Partizanska” (PK 19424/1), si pikë prerëse me kufirin verior të zonës kontaktuese;

- në veri kufiri fillon nga pika prerëse me kufirin perëndimor të zonës kontaktuese dhe lëviz në drejtim të lindjes nëpër boshtin e rrugës “Partizanska”, (PK 19424/1), si kufi jugor i të mirës, deri në pikën e prerjes me kufirin lindor si pikë përfundimtare e përshkrimit të kufijve të zonës kontaktuese “Park”.

Neni 7

(1) Kufijtë e Qendrës së Vjetër të Qytetit të Manastirit, të komplekseve urbane në përbërje të saj dhe të zonave kontaktuese të Qendrës së Vjetër të Qytetit të Manastirit sipas neneve 3, 5 dhe 6 të këtij ligji (në tekstin e mëtutjeshëm: zona e mbrojtur), Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive i sjell në bazë gjeodezike në përmasa 1:1000.

(2) Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive, për çdo parcelë kadastrale që gjendet në kufijtë e tërësisë monumentale, në evidencë kadastrale dhe dokumentacion vendos shënim se është pjesë përbërëse e Qendrës së Vjetër të Qytetit të Manastirit si trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë, ndërsa për çdo parcelë kadastrale që gjendet në kufijtë e zonës kontaktuese, në evidencën kadastrale dhe dokumentacion vë shënim se është pjesë përbërëse e zonës kontaktuese

të tërësisë monumentale. Për çdo të mirë të mbrojtur në kufijtë e zonës së mbrojtur në evidencën kadastrale dhe dokumentacion vë shënim se ka status të trashëgimisë kulturore me kategori përkatëse të përcaktuar me aktin për shpalljen e saj.

(3) Kufijtë i zonës së mbrojtur nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të ndryshohen me plan hapësinor dhe urbanistik as me lloj tjetër të aktit përveç me akt për mbrojtje ose akt për ndryshim në pajtim me rregullat për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.

Neni 8

(1) Për shkak të mbrojtjes, rregullimit, revitalizimit dhe shfrytëzimit racional të Qendrës së Vjetër të Qytetit të Manastirit, Komuna e Manastirit miraton plane të veçanta dhe të hollësishme urbanistike me përfshirje të planit në komplekset urbane nga neni 5 i këtij ligji që janë në kufijtë e Qendrës së Vjetër të Qytetit të Manastirit.

(2) Për zonat në kontakt nga neni 6 i këtij ligji Komuna e Manastirit miraton plane të hollësishme urbanistike me përfshirje të planit në kufijtë e zonave në kontakt.

(3) Me përjashtim nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni me plan të përgjithshëm urbanistik mund të caktohen edhe përfshirjet më të vogla të planit në kufijtë e përcaktuara të komplekseve urbane dhe zonave në kontakt nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(4) Planet nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni hartohen në bazë të bazave konservatore mbrojtëse të përgatitura nga Institucioni Nacional Enti për Mbrojtjen e Përmendoreve të Kulturës dhe Muzeu - Manastir.

(5) Bazat konservatore mbrojtëse nga paragrafi (4) i këtij ligji hartohen në dinamikën e përcaktuar me Programet për hartimin e planeve urbanistike të Komunës së Manastirit.

Neni 9

Në Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit nuk guxon:

1. të ndryshohet struktura e përhershme urbane e qendrës dhe karakteristikat e saj morfologjike urbane;

2. të ndryshohen: gabariti, katet, përkatësisht lartësia, pamja e fasadave, tipi i kulmit dhe mbuluesi i kulmit dhe materialet burimore të objekteve individuale mbrojtëse;

3. të ndërtohen objekte të reja me kuotë të përdhësës më të lartë se 1.20 m të matur nga trotuari mbrojtës dhe të cilat si lartësi kanë hapësirën në kulm, me apo pa dritare në të, apo janë të mbuluara me tarracë të rrafshët, nëse me rregullat për rregullimin e hapësirës nuk është caktuar ndryshe;

4. të rriten gabariti dhe lartësia e objekteve ndihmëse;

5. të ndërtohen apo të futen kapacitete industriale dhe të ngjashme apo të futen dedikime të reja që dalin nga zhurma, dridhjet dhe ndotja e mjedisit dhe

6. të bëhet gërmim i themelit apo bodrumeve, e as të realizohet cilido lloj i punëve tokësore apo ndërtimore pa u kryer hulumtimet arkeologjike të tokës në Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit, nëse ato janë të caktuara si kusht konservator mbrojtës.

(2) Në Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit regjimi i mbrojtjes përfshin edhe veprime tjera të cilat ndërmerren në pajtim me Ligjin dhe sipas kushteve të definuara në planet detale urbanistike për Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit, që kanë të bëjnë me:

1. ruajtjen e të mirave të mbrojtura në gjendje burimore me mirëmbajtjen e tyre të rregullt dhe përmes preventivës, konservimit, restaurimit dhe sanimit;

2. ruajtjen e objekteve ambientale të cilat kontribuojnë për vlerat dhe për dukjen ambiente të tërësisë në gjendjen burimore, të dukjes së jashtme të objekteve me konservimin dhe sanimin e tyre, si dhe me restaurimin e elementeve karakteristike arkitektonike të fasadave të cilat kanë dëmtime;

3. kthimin e pamjes autentike të fasadës së atyre objekteve që e kanë humbur, e për të cilat ekzistojnë informata të mjaftueshme;

4. kthimin e fondit të humbur të objekteve në lokacione të cilat janë të lira dhe për të cilat ekzistojnë plane të vjetra urbanistike, mbetje nga objektet ose fotodokumentacion teknik përmes rikonstruimit të tyre, përkatësisht ripërtëritje tipologjike;

5. interpolacionin e kontrolluar të objekteve të reja të lokacioneve të lira;

6. mbajtjen e objekteve ambientale në korniza të gabariteve ekzistuese me mundësi për ndërtime shtesë më të vogla në lokacionet personale të cilat nuk do të ndikojnë në ndryshimin e ambientit dhe fasadës së rrugës;

7. mbajtjen dhe ndërtimin e objekteve me kulme në më shumë përçues dhe me pjerrësi të vogël (maksimum 22% deri 25%), ndërsa për objektet të cilat janë në varg, kulme në dy përçues me pjerrësi të vogël, me përdorim të domosdoshëm të qeramikës si material për mbulim;

8. mbajtjen e numrit, ritmit, madhësisë dhe formës së hapjeve të objekteve, elementeve dekorative të fasadave, llojit të rrethojave, erkerëve dhe materialeve nga të cilat janë bërë, qosheve metalike, simsove, timpanonëve dhe elementeve tjera karakteristike arkitektonike;

9. suvatimin dhe përpunimin final të fasadave të objekteve në Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit që nuk janë të përfunduara;

10. mbajtjen dhe kthimin e ngjyrës autentike e fasadave të objekteve;

11. përdorimin e drurit kualitativ për përpunimin orendive të zdrukthëtarisë në vend të metalit ose limit të plastifikuar dhe mënjanimin gradual, përkatësisht zëvendësimin e profileve të plastifikuara ose metalike të përdorura në fasadat rrugore dhe të dyqaneve;

12. mbajtjen e funksioneve themelore të Qendrës së Vjetër të Qytetit të Manastirit dhe kthimin e disa funksioneve burimore, siç janë zejet e vjetra, ose dhënieve funksionale bashkëkohore disa objekteve nëse funksionet e tilla janë kompatible me natyrën e tyre dhe karakterin e tërësisë përkujtimore;

13. rrethimin e hapësirave të hapura në Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit në mënyrë që siguron që të mos rrënohet integriteti i saj;

14. vendosjen, përkatësisht fshehjen e të gjitha llojeve të përçuesve të infrastrukturës dhe instalimeve në mënyrë që siguron të mos jenë të dukshme në fasadat rrugore dhe në hapësirën në Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit;

15. rregullimin parter të Qendrës së Vjetër të Qytetit të Manastirit me përdorimin e materialeve natyrore të rrjedhave ekzistuese të rrugëve me kalldrëm dhe katrorë të ruajtur;

16. inkuadrimin e të gjitha mbishkrimeve të firmave dhe mbishkrimeve tjera, shenjave të komunikacionit, sinjalizimit monumental, ndriçimit dhe pajisjes urbane të hapësirave të hapura, përkatësisht vendosjen e tyre në bazë të ligjit;

17. ndërmarrjen e masave parandaluese dhe korrektive kundër efekteve destruktive nga zhurma, goditjet dhe vibracionet e shkaktuara nga makinat dhe automjetet në Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit, si dhe nga format e ndryshme të ndotjes së rrethinës në zonën e tërësisë monumentale;

18. rregullimin e posaçëm të regjimit të komunikacionit të Qendrës së Vjetër të Qytetit të Manastirit, qarkullimin e automjeteve të rënda ngarkuese dhe parkimin e automjeteve motorike dhe mënjanimin që të realizohen parkingje të mëdha;

19. rregullimin parter në zonës së këmbësorëve në kufijtë e Qendrës së Vjetër të Qytetit;

20. zmadhimin e gjelbërimit të qytetit;

21. mënjanimin e objekteve jopërkatëse të përkohshme dhe pajisjes urbane dhe

22. ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve tjera mbrojtëse në zonën e komplekseve të ndara urbane në qendër në pajtim me këtë ligj.

Neni 10

(1) Në kufijtë e Kompleksit Urban - 1: "Çarshia e vjetër", në zonën e të mirës të mbrojtur të veçantë - kompleks monumental "Çarshia e vjetër e Manastirit", krahas masave mbrojtëse të cekura si elemente të përbashkëta të regjimit të mbrojtjes për Qendrën e vjetër të Qytetit të Manastirit nga neni 9 paragrafi (1) i këtij ligji, nuk guxon:

1. të ndryshohet rrjeti ekzistues në rrugën e çarshisë, as forma dhe madhësia e blloqeve të çarshisë;

2. të ndryshohet pamja e rrugëve të çarshisë me të gjitha karakteristikat e tyre themelore;

3. të ndryshohen forma, madhësia, struktura dhe pamja e shtratit të lumit, përfshirë urat ekzistuese të lumit Dragor në pjesën që bie në kufijtë e Çarshisë;

4. të bëhet ridedikimi i hapësirës në tregun ekzistues të gjelbër të çarshisë;

5. të ndërtohet erker më i madh se 0.50 m;

6. të ndërtohen garazhe si objekte të veçanta në parcelën ndërtimore;

7. të mbulohen objektet me materiale që nuk janë standarde për zonat e mbrojtura;

8. të vendosen mbajtës, antena, repetitorë, panele të mëdha reklamash dhe pajisje e ngjashme dhe aparatura të objekteve dhe të hapësirave të hapura, në kundërshtim me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe

9. të kryhen veprime tjera të palejuara me aktin për mbrojtje të "Çarshisë së vjetër të Manastirit", ndërsa për objektet e mbrojtura të veçanta në Çarshinë, dhe veprimet e përcaktuara me aktet për mbrojtje të atyre objekteve.

(2) Në kufijtë e Kompleksit urban - 1: "Çarshia e vjetër", në zonën jashtë kufijve të kompleksit monumental "Çarshia e vjetër e Manastirit", krahas masave mbrojtëse të cekura në si elemente të përbashkëta të regjimit të mbrojtjes për Qendrën e vjetër të Qytetit të Manastirit nga neni 9 paragrafi (1) i këtij ligji, nuk guxon:

1. të ndërtohet erker me çfarëdo lloj përmasash, me përjashtim të ndërtesave të reja të lokalizuara në afërsi të objektit të vjetër ekzistues me ballkon, me përmasa më të mëdha se të tij;

2. të mbulohen objektet me materiale që nuk janë standarde për zonat e mbrojtura;

3. të vendosen mbajtës, antena, repetitorë, panele të mëdha reklamash dhe pajisje e ngjashme dhe aparatura të objekteve dhe të hapësirave të hapura, pa leje paraprake të Drejtorisë për mbrojtje të trashëgimisë kulturore;

4. të kryhen veprime tjera të palejuara në objektet e mbrojtura të veçantë në atë zonë të kompleksit urban në pajtim me këtë ligj.

(3) Në kufijtë e Kompleksit urban - 1: "Çarshia e vjetër", krahas veprimeve nga neni 9 paragrafi (2) i këtij ligji, regjimi i mbrojtjes përfshin edhe veprime tjera që ndërmerren në pajtim me ligjin dhe sipas kushteve të definuara në planin e detajuar urbanistik për kompleksin urban, që kanë të bëjnë me:

1. formimin plotësues të rrjetit rrugor dhe të blloqeve urbane;

2. ruajtjen e pamjes autentike të shitoreve, me ndërhyrje të kufizuar me të cilat përmirësohen kushtet për funksionimin e tyre;

3. rregullimin e pamjes së rrethojave të rrugës dhe rrethimin e oborreve dhe portave;

4. ndërtimin plotësues dhe mbindërtimin e objekteve ambientale, që nuk janë të mira të mbrojtura të veçanta, e që kontribuojnë për vlerat dhe pamjen ambientale të kompleksit, me ruajtje të elementeve karakteristike të objektit dhe

5. masat dhe aktivitetet tjera përkatëse mbrojtëse të përcaktuara me aktin për mbrojtje të "Çarshisë së vjetër të Manastirit", e për objektet e veçanta të mbrojtura në kufijtë e kompleksit urban, dhe masat mbrojtëse të përcaktuara me aktet për mbrojtje të atyre objekteve.

Neni 11

(1) Në kufijtë e Kompleksit Urban – 2: "Shirok Sokak", në rajonin e të mirës së veçantë të mbrojtur – Tërësi monumentale "Rruga Ambientale Marshall Tito" (rruga "Shirok sokak"), përveç masave të mbrojtjes të përmendura si elemente të përbashkëta të regjimit të mbrojtjes nga neni 9 paragrafi (1) nga ky ligj, nuk guxon:

1. të ndryshohet pamja e rrugës dhe të karakteristikave themelore të saj;

2. të ndërtohen objekte të reja të hapësirave publike të hapura ekzistuese në kufijtë e rrugës (sheshe dhe sipërfaqe të gjelbra), nëse me bazat mbrojtëse-konservatore përkatësisht kushtet mbrojtëse-konservatore përkatësisht planet urbanistike të hollësishme nuk është caktuar ndryshe.

3. të ndërtohet erker me çfarë do qoftë dimensione;

4. të ndërtohen garazhe si objekte të veçanta të parcelës ndërtimore;

5. të mbulohen objektet me materiale të cilat nuk janë standarde për rajonet mbrojtëse;

6. të vendosen mbështetës, antena, repetitorë, pano të mëdha reklamuese dhe pajisje të ngjashme në objektet dhe në hapësirat e hapura, në kundërshtim me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore; dhe

7. të kryhet veprime tjera të palejuara të përcaktuara me aktin për mbrojtjen e rrugës, ndërsa për objektet e mbrojtura në mënyrë të veçantë në kufijtë e asaj rruge, dhe veprime të përcaktuara me aktet për mbrojtje të atyre objekteve.

(2) Në kufijtë e Kompleksit Urban – 2: “Shirok Sokak”, në rajonin jashtë nga kufijtë e tërësisë monumentale “Rruga Ambientale Marshall Tito” (rruga “Shirok sokak”), përveç masave të mbrojtjes të përmendura si elemente të përbashkëta të regjimit të mbrojtjes nga neni 9 paragrafi (1) nga ky ligj, nuk guxon:

1. të ndryshohet rrjeti ekzistues rrugorë as forma dhe madhësia e blloqeve urbane;

2. të realizohet erker me çfarë do qoftë dimensione, me përjashtim të ndërtimeve të reja të lokuara në afërsi të objektit të vjetër ekzistues me erker, me dimensione më të mëdha nga ai;

3. të ndërtohen garazhe si objekte të veçanta të parcelës ndërtimore;

4. të mbulohen objektet me materiale të cilat nuk janë standarde për rajonet mbrojtëse;

5. të vendosen mbështetës, antena, repetitorë, pano të mëdhaja reklamuese dhe pajisje të ngjashme në objektet dhe në hapësirat e hapura, në kundërshtim me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe

6. të kryhen veprime tjera të palejuara në objektet e mbrojtura në mënyrë të veçantë në atë rajon të kompleksit urban të përcaktuara me aktet për mbrojtje të atyre objekteve.

(3) Në kufijtë e Kompleksit Urban – 2: “Shirok sokak”, përveç veprimeve nga neni 9 paragrafi (2) nga ky ligj, regjimi i mbrojtjes inkuadron edhe veprime tjera që ndërmerren në pajtim me ligjin dhe sipas kushteve të definuara në planin urbanistik të hollësishëm për kompleksin urban që kanë të bëjnë me:

1. formësimin plotësues të rrjetit rrugorë në kufijtë e kompleksit urban, në kuptim të definimit të profilin të pjsëmarrësve në komunikacion dhe qasjeve, rikonstruksionit të korsive, formimin e trotuareve, kalldrëmin, përkatësisht vendosjen e mbulesës adekuate parterre, rregullimin e vendeve për obor dhe rrethimin e tyre, rregullimin e dukjes së rrethoreve rrugore dhe portat dhe tjera;

2. formësimin plotësues të ambienteve rrugore karakteristike të rrugëve: “Elpida Karamandi”, “Marks dhe Engels”, “Ruzveltova”, “Dobrivoje Radosavleviq”, “27 Mars”, “11 Tetori”, “Jorgo Osmano”, “Sterjo Georgiev”, “Tomaki Dimitrovski” dhe rrugë tjera apo pjesë të tyre që ju takojnë Kompleksit Urban – 2: “Shirok Sokak” dhe rrugëve tjera në kompleksin urban;

3. ndërtim plotësues dhe mbindërtim të objekteve ambientale, të cilat nuk janë të mira të mbrojtura në mënyrë individuale, ndërsa të cilat kontribuojnë për vlerat dhe pasqyrës ambientale të tërësisë, me ballafaqim të elementeve karakteristike të objektit dhe

4. masa dhe aktivitete tjera mbrojtëse adekuate të përcaktuara me aktin për mbrojtjen e “Rrugës ambientale Marshall Tito” (rruga “Shirok Sokak”), ndërsa për objektet e mbrojtura në mënyrë të veçantë në rajonin e kompleksit urban, dhe masat mbrojtëse të përcaktuara me aktet për mbrojtje të atyre objekteve.

Neni 12

(1) Në kufijtë e Kompleksit urban - 3: "Dërvën Pazar", krahas masave të mbrojtjes të theksuara si elemente të përbashkëta të regjimit të mbrojtjes nga neni 9 paragrafi (1) të këtij ligji, nuk guxon:

1. të ndryshohet rrjeti i përhershëm i rrugës as forma dhe madhësia e blloqeve urbane;
 2. të kryhet ridedikim i hapësirës që e përfshin parkun "Sinan-bej" ("Stiv Naumov") dhe në hapësirat tjera të hapura publike në kufijtë e kompleksit urban, nëse me bazat tjera të mbrojtura konservatore, respektivisht kushtet e mbrojtura konservatore, respektivisht planet e detajuara urbanistike nuk është përcaktuar ndryshe dhe
 3. të kryhen veprime tjera të palejuara të objekteve të mbrojtura në veçanti në rajonin e kompleksit urban me aktet për mbrojtjen e atyre objekteve.
- (2) Në kufijtë e Kompleksit urban - 3: "Dërven pazar", krahas veprimeve nga neni 9 paragrafi (2) të këtij ligji, regjimi i mbrojtjes përfshin edhe veprime tjera që ndërmerren në pajtim me ligjin dhe sipas kushteve të saktësuara në planin e hollësishëm urbanistik për kompleksin urban që kanë të bëjnë me:
1. formësimin plotësues të rrjetit të rrugëve në kufijtë e kompleksit urban, në këndvështrim të saktësimit të profilit të infrastrukturës së komunikacionit rrugor, rikostruimin e korsive, formimin e trotuareve, vendosjen e pllakave, respektivisht vendosjen e mbulesës adekuate parter etj.;
 2. formësimin plotësues të blloqeve urbane kompaktësia e të cilave është prishur;
 3. ndërtime dhe mbindërtime të objekteve ambientale, të cilat nuk mbrohen në mënyrë individuale, dhe të cilat kontribuojnë për vlerat dhe pasqyrën ambientale të tërësisë, me ruajtjen e elementeve karakteristike të objektit;
 4. rregullimin e vendeve të oborrit dhe rrethimi dhe rregullimi i tyre në pamjen e rrethojave përkaj rrugës dhe të portave;
 5. formësimin plotësues të ambienteve rrugore karakteristike të rrugëve: "Car Samoil", "Sterjo Georgiev", "Stevo Patako", "Kuzman Josifovski", "Cirili dhe Metodi", "Sllavko Lumbarkovski", "Bellgradska", "Stiv Naumov", "Ohridska" dhe rrugë tjera ose pjesë të tyre që i takojnë kompleksit Urban - 3: "Drven Pazar, si dhe në ambientet rrugore të rrugëve tjera në kompleksin urban dhe
 6. masa tjera adekuate mbrojtëse dhe aktivitete për objektet e mbrojtura në veçanti në rajonin e kompleksit urban, të përcaktuara me aktin për mbrojtjen e atyre objekteve.

Neni 13

- (1) Në kufijtë e Kompleksit urban - 4: "Bulevard", krahas masave mbrojtëse të theksuara si elemente të përbashkëta të regjimit të mbrojtjes nga neni 9 paragrafi (1) të këtij ligji, nuk guxon:
1. të ndryshohet rrjeti i përhershëm i rrugës as forma dhe madhësia e blloqeve urbane;
 2. të realizohet erker më i vogël se 0,50 m, dhe më i madh se 0,80 m dhe në lartësi më të vogël se 3,60m se niveli i rrugës "Bulevardi 1 Maji" dhe
 3. të kryhen veprime tjera të palejuara të objekteve të mbrojtura në veçanti në rajonin e kompleksit urban me aktet për mbrojtjen e atyre objekteve.
- (2) Në kufijtë e Kompleksit urban - 4: "Bulevard", krahas veprimeve nga neni 9 paragrafi (2) të këtij ligji, regjimi i mbrojtjes përfshin edhe veprime tjera që ndërmerren në pajtim me ligjin dhe sipas kushteve të saktësuara në planin e hollësishëm urbanistik për kompleksin urban që kanë të bëjnë me:
1. formësimin plotësues të rrjetit të rrugëve në kufijtë e kompleksit urban, në këndvështrim të saktësimit të profilit të infrastrukturës së komunikacionit rrugor, rikostruimin e korsive, formimin e trotuareve, vendosjen e pllakave, respektivisht vendosjen e mbulesës adekuate parter etj.;
 2. formësimin shtesë të blloqeve urbane kompaktësia e të cilave është prishur;
 3. ndërtime dhe mbindërtime të objekteve ambientale, të cilat nuk mbrohen në mënyrë individuale, dhe të cilat kontribuojnë për vlerat dhe pasqyrën ambientale të tërësisë, me ruajtjen e elementeve karakteristike të objektit;
 4. rregullimin e vendeve të jashtme dhe rrethimi i tyre;

5. formësimin shtesë të ambienteve karakteristike rrugore në kompleksin urban dhe
6. masa tjera adekuate mbrojtëse dhe aktivitete për objektet e mbrojtura në veçanti në rajonit të kompleksit urban, të përcaktuara me aktin për mbrojtjen e atyre objekteve.

Neni 14

- (1) Në zonat e kontaktit në Qendrën e Vjetër e Qytetit të Manastirit, nuk guxon:
 1. të ndryshojë rrjeti ekzistues rrugor nëse me atë prishet ose pamundësohet komunikimi funksional me Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit në cilën do pjesë të saj;
 2. të ndryshohen gabariti, lartësia dhe dukja e fasadës të objekteve të mbrojtura në mënyrë individuale;
 3. të futen çfarë do kapacitetesh dhe të vendosen dedikime që kontribuojnë për prezencën e formave të ndryshme të ndotjes ose shkaktojnë zhurmë, dridhje dhe goditje dhe
 4. të kryhen punë tokësore ose punë tjera ndërtimore në kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
- (2) Në zonat kontaktuese në Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit regjimi i mbrojtjes përfshin edhe veprime tjera që ndërmerren në pajtim me ligjin dhe sipas kushteve të saktësuara në planet e detajuara urbanistike në zonat kontaktuese që kanë të bëjnë me:
 1. ruajtjen e gjendjes ekzistuese të objekteve të ndërtuara me mundësi për intervenime adekuate ndërtimore që nuk do ta prishin integritetin e rajonit të mbrojtur;
 2. formimi i hapësirave të hapura në mënyrë që siguron që të mos prishet integriteti i pjesës në fjalë nga rajoni i mbrojtur;
 3. interpolacioni i kontrolluar i objekteve të reja në lokacione të lira dhe
 4. harmonizimi i gabaritit dhe lartësia e objekteve të reja në mënyrë në të cilën pamundësohet mbyllja e vizureve drejt dhe nga Qendra e Vjetër e Qytetit të Manastirit.

Neni 15

- (1) Me Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit, në emër të Republikës së Maqedonisë, menaxhon Institucioni Nacional Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeu - Manastir, ndërsa në emër të bashkësisë lokale, menaxhon komuna e Manastirit.
- (2) Për shkak të sigurimit të kushteve të veçanta për ruajtje të trefishtë të tërësisë monumentale dhe për mënjanimin e shkaqeve që i rrezikojnë vlerat e saj, si dhe për shkak të realizimit të koordinuar të iniciativave të përbashkëta, aksioneve ose projekteve për mbrojtje, rregullim, shfrytëzim dhe realizim të Qendrës së Vjetër të Qytetit të Manastirit, Institucioni Nacional Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeu - Manastir dhe komuna e Manastirit përpilojnë plan për menaxhim me Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit (në tekstin në vijim: Plani për menaxhim) në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
- (3) Planin për menaxhim e miraton Këshilli Drejtues Institucioni Nacional Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeu - Manastir, me propozim të drejtorit dhe këshillit të komunës së Manastirit, dhe me pëlqim të marrë paraprakisht nga Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe nga Ministria e Kulturës.
- (4) Plani për menaxhim duhet t'i përmbajë masat dhe aktivitetet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, edhe atë:
 - hyrje (kontroll të të mirave të mbrojtura të patundshme me vlera, rëndësi, veçori, kufij të shënuar në tekst dhe nëpërmjet hartës, metodologji të përgatitjes dhe gjendjes);
 - zhvillim historik;
 - menaxhim;
 - faktorë dhe rreziqe;
 - potenciale dhe vizion;
 - qëllime kryesore të planit;
 - planifikim të zhvillimit urbanistik dhe rehabilitim urban;

- plan aksionar për zbatimin e planit me implikime fiskale të nevojshme për zbatimin e tij;
- subjekte dhe mënyrë e zbatimit të planit dhe
- rezyme dhe shtojca adekuate të panit.

(5) Plani për menaxhim para miratimit të tij vendoset në diskutim publik. Mendimet, propozimet dhe rekomandimet e paraqitura në diskutimin publik merren parasysh gjatë përpilimit të planit për menaxhim.

(6) Plani për menaxhim miratohet në periudhë prej pesë vitesh.

(7) Subjektet, të cilat në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, menaxhojnë me Qendrën e Vjetër të Qytetit të Manastirit, më së voni deri më 31 janar të viti rrjedhës për vitin paraprak, duhet të dorëzojnë te Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore raport vjetor për zbatimin e planit për menaxhim.

(8) Subjektet nga paragrafi (3) i këtij neni janë të obliguara të fillojnë me përpilimin e planit të ri për menaxhim më së voni gjashtë muaj para kalimit të afatit për të cilin është miratuar plani për menaxhim.

(9) Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore e përcjell zbatimin e planit për menaxhim nga paragrafi (1) i këtij neni.

MBIKËQYRJA

Neni 16

(1) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji kryen Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në pajtim me këtë ligj dhe me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.

(2) Lidhur me zbatimin e rregullave për ndërtim dhe planifikimin hapësinor dhe urbanistik, mbikëqyrje dhe kontroll kryejnë organet kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit dhe hapësirës.

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 17

(1) Revalorizimi i monumenteve të kulturës të cilat gjenden në përfshirjen e rajonit të mbrojtur nga neni 7 paragrafi (1) nga ky ligj, e cilësia e monumentit të kulturës është përcaktuar me vendim nga Instituti Nacional- Enti për Mbrojtjen e përmendoreve dhe Muzeu Manastir, do të mbarojë në mënyrë dhe në procedurë përcaktuar me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në afat prej dy viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Revalorizimi i të mirave për të cilat në mënyrë të bazuar supozohet se janë trashëgimi kulturore, kurse të cilat gjenden në rajon të mbrojtur nga neni 7 paragrafi (1) nga ky ligj dhe janë evidentuar në evidencën e mbrojtur nga Instituti Nacional- Enti për Mbrojtjen e përmendoreve dhe Muze Manastir, do të mbarojë në mënyrë dhe në procedurë përcaktuar me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në afat prej dy viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Planet urbanistike detale nga neni 8 paragrafi (1) dhe (2) nga ky ligj do të miratohen në afat prej pesë viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(4) Deri në miratimin e planeve nga paragrafi (3) të këtij neni, mbrojtja e rajonit të mbrojtur nga neni 7 paragrafi (1) të këtij ligji realizohet në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe dispozitave për ndërtim dhe planifikim hapësinor dhe urbanistik.

Neni 18

Plani për menaxhim nga neni 15 paragrafi (2) të këtij ligji do të miratohet në afat prej 12 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.